



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2021

**VENDIM**  
**Nr. 492, datë 19.10.2021**

**PËR**  
**CAKTIMIN E GJYQTARËVE TË SKEMËS SË DELEGIMIT PËR GJYKIMIN E DY**  
**ÇËSHTJEVE GJYQËSORE NË GJYKATËN E POSAÇME TË APELIT PËR**  
**KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a”, të pikës 4 dhe pikën 7, të nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 13, të Vendimit të tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dërguar me Shkresën nr. 402 prot., datë 07.10.2021, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4614 prot., datë 08.10.2021 dhe Shkresën nr. 411 prot., datë 12.10.2021, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4696 prot., datë 13.10.2021, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe mbas shortit të hedhur,

**VENDOSI:**

1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. Engert Pëllumbi caktohet për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 245/1/2 i Kodit Penal”;
2. Gjyqtari i skemës së delegimit z. Florjan Kalaja caktohet për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/a/1 e 22, 28/4, 300/1 e 25, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal”;
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarëve z. Engert Pëllumbi dhe z. Florjan Kalaja, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**